



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-21480, dt. 17 Prill 2025

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008, nenëve 6 par.1.2, 7, 8 para. 1.3, 11 dhe 23 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, neneve 4, 5 paragrafi 1.3, 6, 13, 14, si dhe nenit 23 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale – ZK Lutogllavë për Panela Solare, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi i Komunës Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 17 Prill 2025, merr këtë:

VENDIM

Nr. 14/2025

Mbi miratimin për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negociim nga Kryetari i Komunës

- I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare, në afat prej tridhjetë (30) viteve sipas Vendimit Nr. 61-2024 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim në vitin 2025, me nr. Prot. 400/01-87552, dt. 29 Tetor 2024.

PRONARI Poseduesi	Nr. i Ngastrës	Emri i rrugës (lokacioni)	Sipërfaqja	Zona Kadastrale	Destinimi	Periudha
K.K. Pejë	00167-6	Fsh. Lutogllavë	112258 m ²	ZK Lutogllavë	Panela Solare	30 vite

- II. Pas plotësimit të kushteve ligjore Kuvendi i Komunës e autorizon Kryetarin e Komunës në nënshkrimin e kontratës së qirasë me LIMAK për periudhën 30 vjeçare. LIMAK është një shoqëri e inkorporuar sipas ligjeve të Turqisë, me seli në Hafta Sokak, Ankara/Turqi, e cila do të detyrohet të regjistroj një kompani në Kosovë për zhvillimin dhe operimin e një projekti diellor prej 8 MW ("Projekti" ose "SPP") brenda territorit të Komunës së Pejës, ndërsa komuna është e gatshme për dhënien e pronës komunale me qira afatgjatë prej 30 vitesh të qirasë për zhvillimin e Projektit të Centralit Diellor.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Çështje Pronësores-Juridike.

- IV. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

*MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.*

